



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr.201/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada Glligjani kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Kymete Kicaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Pejë, paraqitur kundër subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Gjakovë, për shkak të nxitjes së urrejtjes, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.10.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa Anr.201/2019 e datës 03.10.2019, e paraqitur nga Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Pejë, kundër subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Gjakovë, për shkak të nxitjes së urrejtjes gjatë fushatës zgjedhore.

### A r s y e t i m

Subjekti politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Pejë, më datë 03.10.2019, ka paraqitur ankesë në PZAP, me të cilën pretendon se me datë 02.10.2019, në orën 22:10, z.Avdyl Berisha, kryetar i degës në Pejë nga radhët e subjektit politik IRDK, ka postuar në llogarinë e tij personale në rrjetin social facebook, fotografi të z.Mirsad Berisha, nënkryetar i degës në Pejë nga radhët e subjektit politik PLE, me mbishkrimin "*Rrenca i Pejës, Mirsad K Berisha*". Si dëshmi për këtë gjendet e bashkangjitur në ankesë fotografia numër 1, 2 dhe 3, ndërsa më tutje në pyetjen e një personi tjetër se kush është personi fotografin e të cilit e ka postuar z.Avdyl Berisha, ky i fundit në një koment më poshtë shkruan se: "*Ky është rrencan*", që i referohet z.Mirsad Berisha, pjesë e subjektit PLE, si dëshmi për këtë gjendet e bashkangjitur në ankesë fotografia numër 4, pastaj përsëri z.Avdyl Berisha vazhdon me komente ofenduese, denigruese dhe fyese ndaj z.Mirsad Berishës me shprehjet si "*Lperi i pejes zagagar*", (Laperi i Pejës, zagar) dhe "*Do qen të sharit e do zagar të vetonit*", (siç mund ta dini Vetoni është kryetar i subjektit politik PLE- Veton Berisha), dëshmi për këtë janë fotografitë me numër 5 dhe 6.

Parashtruesi i ankesës më tutje thekson se subjekti politik IRDK, ka zgjedhur gjuhën fyese, denigruese, nxitëse dhe ofenduese ndaj të gjithë kandidatëve dhe mbështetësve të subjektit tonë, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me nenin 33 pika 1 të LPZ-së, këtë e dëshmon edhe vendimi i nxjerrë nga ju Anr.148/2019 i datës 02.10.2019, përmes së cilit dënohet në vlerë 1,200.00 euro subjekti politik IRDK.

Në përgjigje në ankesë të datës 04.10.2019, subjekti politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), thekson se ankesa e parashtuar ndaj subjektit tonë është e pabazuar, sepse një person i identifikuar nga PLE, në rrjetin social facebook, me emrin Avdyl Berisha, nuk ka të bëjë asgjë me subjektin politik IRDK, ngase me një kërkim të thjeshtë në facebook, gjejmë disa llogari me emrin Avdyl Berisha, kjo dëshmohet në bazë të fotografisë që e kemi bashkangjitur në përgjigje.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar të Kodit të Mirësjelljes nga ana e subjektit politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se paraqitësi i ankesës nuk ka arritur që të argumentojë me prova bindëse pretendimet e tij ashtu siç parashihet me nenin 117 par.3 të LZP-së në mënyrë që paneli, të merr vendim në favor të tij.

Nga arsyet e theksuara më lartë, e duke u bazuar në nenin 115 par.1 dhe nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Anr.201/2019 më datën 05.10.2019**

**Kryesuese e Panelit**  
**Afijetë Sada Glllogjani**



***Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.***